

**Legal cert shpk** eshte nje Organ i vleresimit te konformiteti qe vepron ne fushen e çertifikimit sipas kritereve te pergjithshme te percaktuara nga Standardi EN ISO/IEC 17021-1:2015 dhe si Organizem i pavarur, ofron sherbime vleresimi dhe çertifikimi te konformitetit te Sistemeve te Menaxhimit sipas parashikimeve te Standardit te lartpermendur

**Legal cert shpk** i drejtohet te gjithe subjekteve te pranishem ne treg, pa paragjykime te natyres diskriminuese me qellim qe te mos perjashtoje ose kufizojë aksesin ne çertifikim per cilindo qe e kerkon ate, pavaresisht permasave dhe perkatesise ne çfaredo lloj grupi ose shoqate. Organi vepron duke ndjekur ne menyre konstante politiken e tij dhe zotohet te:

- Te ushtroje aktivitet vleresimi dhe çertifikimi te Sistemeve te Menaxhimit me paanshmeri dhe objektivitete, ne zbatim te interesit te paleve te perfshira.
- Te kryeje procesin e vleresimit dhe çertifikimit te konformitetit si parashikohet nga rregulloret ne fuqi dhe sipas kerkesave te Drejtorise se Pergjithshme Te Akreditimit;
- Te permbushe gjithnje kerkesat dhe nevojat e tregut, te paleve te interesuara (prodhues dhe konsumatore) dhe ne interesin te komunitetit;
- Te ushtroje veprimtarine me rigorozitet, ndershmeri duke u bazuar ne te dhena objektive dhe reale, duke garantuar kompetencen maksimale dhe pergatitjen e burimeve njerezore te perfshira ne proces;
- Te garantoje aftesi per te monitoruar dhe realizuar nevojat e paleve te interesuara me respekt reciprok ne te gjithe subjekteve te perfshira;
- Te shpreh, nepermjet qendrimeve korrekte, gjykime serioze, te paanshme, aftesi te bazuara gjithnje ne te dhena dhe prova objektive.
- Te organizoje seminare ose kurse formimi ne bashkepunim me ente dhe institucione.
- T'i ofroje klienteve disponibilitet maksimal dhe kompetence me qellim permiresimin e vazhdueshem te proceseve.
- Te realizoje perhapje te sherbimeve te veta edhe drejt tregjeve te huaja.
- Te garantoje sigurine dhe shendetin e burimeve njerezore dhe klienteve te saj, protokollet e sigurise dhe kryerjen e proceseve te vleresimit te konformitetit ne distance ne perputhje me direktivat e pergjithshme ne IAF dhe/ose entit akreditues Drejtorise se Pergjithshme Te Akreditimit.

Shtator, 2021

Drejtoria e Pergjithshme